



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.29

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Udhëzim i MPPTT dhe MSH nr.1, datë 31.3.2006	Mbi përcaktimin e kushteve të veçanta që duhet të plotësojnë automjetet e varrimit..... 949
Vendim i ERE nr.17, datë 28.3.2006	Për miratimin e sistemit të informacionit që i licencuari publik OST sh.a. duhet të dërgojë në ERE..... 950
Vendim i ERE nr.18, datë 28.3.2006	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k..... 961
Vendim i ERE nr.19, datë 28.3.2006	Për miratimin e rregullores mbi kushtet dhe standardet e përgjithshme për marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike, ndërmjet një të licencuari dhe një furnizuesi të energjisë elektrike..... 961
Vendim i ERE nr.20, datë 28.3.2006	Për vendosjen e gjobës ndaj KESH sh.a..... 969

UDHËZIM
Nr.1, datë 31.3.2006

MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË VEÇANTA QË DUHET TË PLOTËSOJNË
AUTOMJETET E VARRIMIT

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 24 pika 3 të ligjit nr.9220, datë 15.04.2004 “Për shërbimin publik të varrimit”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit edhe Ministri i Shëndetësisë

UDHËZON:

1. Transportimi i kufomave bëhet vetëm me automjete të posaçme funerali, të cilat, kur transportojnë kufomën, nuk lejohen që të kenë ngarkesë tjetër.

2. Automjetet e varrimit, të destinuara për transportimin e kufomave në rrugët e qyteteve për në varrezë, duhet të jenë të veshura nga brenda me fletë metali inoks ose me material tjetër të papërshkueshëm nga lëngjet dhe që pastrohen e dezinfektohen me lehtësi. Automjeti duhet të jetë i pajisur me karel për fiksimin e arkivolit, që ai të mos lëvizë gjatë transportimit.

3. Këto automjete mund të vihen në shërbimin publik të varrimit nga komuna, bashkia apo subjektet private vetëm pasi të jenë verifikuar dhe konfirmuar si të përshtatshme nga Inspektorati Sanitar Shtetëror, i cili, pasi jep lejën, duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit gjendjen higjienike të tyre.

4. Ndalohet transportimi i kufomave me mjete që shërbejnë për transportin e pasagjerëve, si dhe mjete të destinuara për transportimin e produkteve ushqimore.

5. Automjeti i varrimit, kur transporton një kufomë, pasi kthehet nga varrimi, pastrohet dhe dezinfektohet. Për çdo rast të tillë, në varreza duhet të ketë vende të posaçme ku bëhet dezinfektimi, edhe i gomave të automjeteve, me solucion dezinfektant.

6. Për çdo lëvizje të automjetit të varrimit, duhet të mbahet një regjistër i veçantë nga drejtuesi i tij ose nga subjekti funeral. Ky regjistër paraqitet sa herë e kërkojnë organet e kontrollit.

7. Automjetet e varrimit duhet të parkohen në parkime të vendosura në vende të veçanta, të caktuara me urdhëresë të kryetarit të bashkisë a të komunës duke respektuar normat e rregullores vendore të urbanistikës.

8. Këto vendparkime duhet të jenë të kompletuara me mjetet e nevojshme për pastrimin dhe dezinfektimin e automjeteve të varrimit.

9. Përshtatshmëria e vendeve të parkimit të automjeteve të varrimit duhet të jetë e tillë që të respektojë rregullat kompetente të sigurimit publik dhe të shërbimit zjarrfikës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Lulzim Basha

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Maksim Cikuli

VENDIM
Nr.17, datë 28.3.2006

**PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË INFORMACIONIT QË I LICENCUARI PUBLIK OST
SHA DUHET TË DËRGOJË NË ERE**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 8 pika 2 germa “f” dhe “g”, në të cilat shprehet e drejta dhe autoriteti i ERE-s për të monitoruar dhe kontrolluar shërbimet e të licencuarit, si dhe autoriteti i saj për të inspektuar dhe marrë të dhëna dhe dokumentacion nga i licencuari, si dhe kontrolli që i duhet bërë të licencuarit për të vërtetuar që në shërbimin me energji elektrike që ofrohet prej të licencuarit, ai respekton kushtet e kontratës ose siguron shërbime sipas standardeve dhe kërkesave të vendosura në licencë, Kodin e Sistemit të Transmetimit dhe në ndonjë rregullore tjetër të miratuar nga ERE, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi, analizoi dhe vlerësoi se drafti i sistemit të informacionit që i licencuari publik OST sh.a. duhet të dërgojë në ERE, paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve dhe Departamenti i Licencimit dhe i Monitorimit, realizon marrjen e një informacioni të mjaftueshëm për vlerësimin e performancës së kompanisë, në funksion të monitorimit të saj,

VENDOSI:

1. Miratimin e sistemit të informacionit, që i licensuari publik OST sh.a. duhet të dërgojë në ERE, që përfshin tabelat e mëposhtme, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi:

- Tabela 1: Realizimi i investimeve (6-mujor dhe vjetor)
 - Tabela 2: Bilanci i energjisë (mujor dhe progresiv)
 - Tabela 3: Humbjet teknike në transmetim (6-mujore dhe vjetore)
 - Tabela 4: Realizimi i planit të furnizimit (3-mujor)
 - Tabela 5: Shpenzimet dhe të ardhurat operative (6-mujore dhe vjetore)
 - Tabela 6: Pasqyra *Cash-Flow* (mujore dhe progresive)
 - Tabela 7: Tabela e ndërprerjeve në sistemin e transmetimit
 - Tabela 8: Tabela e energjisë së tranzituar (mujore)
 - Tabela 9: Tabela e kërkesave për lidhje të reja (3-mujore)
 - Tabela 10: Tabela e devijimeve të energjisë kundrejt parashikimeve (mujore).
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema**

Tabela 1 Realizimi I Investimeve (6 mujore dhe vjetore)

NR	Objektet	VLERESIMI I PLOTE I PROJEKTIT			Programi vjetor I investimeve			Realizimi 6 mujor			Diferencat	
		Total	K/ Hualj	K/ lokale	Total	K/ Hualj	K/ lokale	Total	K/ Hualj	K/ lokale	ne vlere	ne perqindje
		000 Leka	000 Leka	000 Leka	000 Leka	000 Leka	000 Leka	000 Leka	000 Leka	000 Leka	000 Leka	%

BILANCI I ENERGJISË (MUJOR DHE PROGRESIV)

Tabela 2

GWh			Muaji		Progresive		Diferencat	
Kërkesa	A		Plan	Fakt	Plan	Fakt	në vlerë	në përqindje
Prodhimi	Prodhimi	1=(H)+(T)						
	Prodhimi me hidro (Tri kaskadat)	(H)						
	Prodhimi me termo (TEC)	(T)=tf+tv						
	TEC Fier	tf						
	TEC Vlorë	tv						
	Konsumi vetjak	2						
	Humbjet në prodhim	3						
	Prodhimi neto i brendshëm	4=(1-2-3)						
Shkëmbimi	Dhënë (+)	(D)						
	Marrë (-)	(R)						
	Balanca (Dhënë - Marrë)	(D)-(R)						
	Eksport (+)	(E)						
	Import (-)	(I)						
	Balanca (Eksport - Import)	(E) - (I)						
	Importet e furnizuesve të kualifikuar	K						
	Balanca e shkëmbimit total neto	5=(D-R+E-I+K)						
Transmetimi	Transmetimi	6=(4+R+I+K)						
	Konsumi vetjak i transmetimit	7						
	Humbjet në transmetim	8						
	Humbjet në %	(8 / 6) %						
	Energjia e ofruar në shpërndarje	9=(6-7-8-D)						

Humbjet teknike ne transmetim

Tabela 3

6 -mujore dhe vjetore

[illegible]

Realizimi I planit te furnizimit - Cdo 3 mujor

Tabela 4
GWh

Muaji	Totali i prodhimit vendas	Importi KESH	Importi Furnizues I Kualifikuar	Total Import	Energjia e disponueshme	Kerkesa	Kufizimet
Janar							
Shkurt							
Mars							
Tremujori I							
Prill							
Maj							
Qershor							
Tremujori II							
Korrik							
Gusht							
Shtator							
Tremujori III							
Tetor							
Netor							
Dijetor							
Tremujori IV							
Totali							

Shpenzimet dhe të ardhurat operative (6-mujore dhe vjetore)

Tabela 5

	Viti			
	Plan	Fakt	Diferencat	
			në vlerë	në përqindje
Të ardhurat operative				
Shitjet e energjisë (KESH) / Shërbimi i Transmetimit (OST)				
të ardhura të tjera				
Totali i të ardhurave operative				
Shpenzimet operative				
Importi i energjisë elektrike				
Prodhimi vendas				
Shpenzime operative për TEC				
Shpenzime për transmetim				
Personeli				
Lënda djegëse (TEC Fier)*				
Blerje materiale dhe produktesh				
Amortizimi				
Furnitorët dhe shërbimet (të tjerë)				
Investimet me punonjësit të vet				
Provizionet për debitorët				
Totali i shpenzimeve operative				
Rezultati operativ				
Të ardhurat financiare				
Nevoja nga buxheti				
Të ardhurat nga interesi				
Fitim nga kursi i këmbimit				
Të ardhura të tjera financiare dhe jofinanciare				
Totali i të ardhurave financiare				
Shpenzimet financiare				
Pagesat e interesit				
Humbjet nga kursi i këmbimit				
Shpenzime të tjera financiare dhe jofinanciare				
Totali i shpenzimeve financiare				
Rezultati financiar				
Fitimi para taksave dhe të jashtëzakonshme				
Të ardhura/(shpenzime) të jashtëzakonshme				
Fitimi para taksave				
Tatim fitimi				
Fitimi i vitit				

Tabela 6

	Viti	
	Muaji	Progresivi
Aktivitet operativ:		
Fitim/(humbja) e vitit		
Amortizimi		
Amortizimi i granteve		
Povizioni		
Rritje(zvogëlim) asetet fikse (rivlerësimi)		
Fitim(humbje) i jashtëzakonshëm		
Fluksi i parasë i gjeneruar nga aktiviteti operativ		
Rregullime për:		
(Zmadhim)/Pakësim i magazinës		
(Zmadhim)/Pakësim i debitorëve për energjinë		
Buxhetorë dhe jobuxhetorë		
Konsumatorë të tjerë		
(Rritje)/Pakësim i parapagesave		
(Rritje)/Pakësim i detyrimeve të shtetit		
(Rritje)/Pakësim i debitorëve të tjerë		
(Rritje)/Pakësim i diferencave nga kursi këmbimit		
Rritje/(Pakësim) në detyrimet afatshkurtra		
Rritje/(Pakësim) në detyrimet për energjinë		
Rritje/(Pakësim) në detyrimet ndaj personelit		
Rritje/(Pakësim) në detyrimet ndaj shtetit		
Rritje/(Pakësim) në detyrimet e tjera		
Rritje/Pakësim të kredive afatgjata pa dokumentacion suportues		
Fluksi i parasë nga aktiviteti i operativ		
Investimet:		
Rritje/pakësim në aktivet jofikse		
Rritje/pakësim në investimet financiare		
Blerje e aseteve fikse		
Shitje e aktiveve fikse		
Të tjera		
Fluksi i parasë nga investimet		
Aktiviteti financiar:		
Rritje në kreditë		
Rritje në kapital+rezervat		
Rritje në rivlerësimin e kapitalit		
Rritje në kreditë e pilotëve		
Fluksi i parasë nga aktiviteti financiar		
Bilanci i fluksit të parasë të ushtrimit		
Gjendja e parasë në fillim të periudhës		
Gjendja e parasë në fund të periudhës		

TABELA NR. 7

TABELA E ENERGJISË SË TRANZITUAR

[illegible]

*Të dhënat dërgohen për çdo tremujor brenda datës 20 të muajit pasardhës.

TABELA NR. 9

TABELA E KËRKESAVE PËR LIDHJE TË REJA

[illegible]

* Të dhënat të dërgohen çdo tremujor brenda datës 20 të muajit pasardhës.

TABELA NR. 10

TABELA E DEVIJIMEVE TË ENERGJISË KUNDREJT PARASHIKIMEVE

[illegible]

* Të dhënat të dërgohen çdo muaj brenda datës 20 të muajit pasardhës.

VENDIM
Nr.18, datë 28.3.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
SHOQËRIA “HYDROELECTRIC COMPANY OF ALBANIA ” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9; 8, pika 2 germa “b”, 26 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.61, datë 25.10.2005 “Për fillimin e procedurave të shqyrtimit”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.60, datë 29.12.2004 “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.3.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydroelectric Company of Albania”, sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2005,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k., për periudhën 1.01.2005 – 31.12.2005, të jetë 4.79 lekë/ kWh.

2. Ngarkohet shoqëria “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema**

**VENDIM
Nr.19, datë 28.3.2006**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI KUSHTET DHE STANDARDET E
PËRGJITHSHME PËR MARRËVESHJET E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
NDËRMJET NJË TË LICENCUARI DHE NJË FURNIZUESI TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.3.2006, pasi shqyrtoi draftin e rregullores mbi kushtet dhe standardet e përgjithshme për marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike, ndërmjet një të licencuari dhe një furnizuesi të energjisë elektrike të paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe i Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencimit dhe i Monitorimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores mbi kushtet dhe standardet e përgjithshme për marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike, ndërmjet një të licencuari dhe një furnizuesi të energjisë elektrike, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha palët që përfshihen në këtë marrëveshje për zbatimin e saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema**

**RREGULLORE MBI KUSHTET DHE STANDARDET E PËRGJITHSHME PËR
MARRËVESHJET E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NDËRMJET NJË TË LICENCUARI
DHE NJË FURNIZUESI TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, në përputhje me Modelin tranzitor të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.539, datë 12.8.2004 dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE.

Neni 2 **Objekti**

Kjo rregullore vendos kushtet dhe standardet e përgjithshme që do të zbatohen për marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike të lidhura nga një i licencuar me një furnizues të energjisë elektrike.

Neni 3 **Qëllimi i rregullores**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i termave dhe kushteve të detyrueshme për çdo marrëveshje të blerjes së energjisë elektrike, të lidhur midis një të licencuari dhe një furnizuesi të energjisë elektrike, me qëllim tregtimin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me standardet dhe parametrat e vendosur në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga ERE.

Neni 4 **Zbatimi**

1. Këto rregulla aplikohen për të gjitha marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike, të lidhura nga një i licencuar dhe një furnizues i energjisë elektrike në sektorin e energjisë elektrike, që janë objekt rregullimi nga ERE.

2. Këto rregulla përmbajnë të gjitha termat, kushtet dhe standardet e përgjithshme që duhet të përfshihen në çdo marrëveshje për blerje të energjisë elektrike të lidhur nga një i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike me një furnizues të energjisë elektrike, gjithmonë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Termat dhe kushtet që nuk rregullohen në mënyrë specifike nga këto rregulla, do të rregullohen nga ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” dhe ligji nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”.

3. Çdo marrëveshje për blerje të energjisë elektrike, e lidhur nga një i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike me një furnizues të energjisë elektrike, do të përfshijë të gjitha termat e kushtet e specifikuar në kapitullin dy të kësaj rregulloreje.

4. Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj rregulloreje është në kundërshtim ose në konflikt me ndonjë dispozitë të akteve të tjera ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 5 **Shmangie nga terma dhe kushte të veçanta**

1. Palët që lidhin një marrëveshje për blerje të energjisë elektrike, që nuk është objekt miratimi me vendim të veçantë të ERE-s në kuptim të nenit 10 germa “j” të Rregullave të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e ERE-s nr.1, datë 25.1.2005, mund të shmangin, në marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike të lidhura mes tyre, aplikimin e disa prej kushteve të kësaj rregulloreje,

me kusht që më parë të japin shpjegim në ERE për termat dhe kushtet që kërkohen të shmangen. Një shmangie do të aplikohet vetëm pas marrjes së vendimit nga ERE.

2. Palët mund të përfshijnë terma dhe kushte të tjera në marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike vetëm nëse këto terma dhe kushte nuk janë në kundërshtim me kushtet e përgjithshme të vendosura në pjesën e dytë të kësaj rregulloreje.

3. Për marrëveshjet që janë objekt miratimi me vendim të veçantë të ERE-s, sipas nenit 10 germa “j” të Rregullave të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e ERE-s nr.1, datë 25.1.2005, për çdo shmangie palët do të japin shpjegime me shkrim gjatë procesit të shqyrtimit dhe miratimit të marrëveshjes në fjalë.

4. Gjatë procesit të shqyrtimit të një shmangieje nga kushtet e përgjithshme, ERE mund të pranojë shmangien, nëse e konsideron në të mirë të palëve, si dhe nëse nxit një treg kompetitiv të energjisë elektrike, përmesh parimet e kostos më të ulët të furnizimit me energji elektrike, si dhe ndikon në rritjen e sigurisë dhe të qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike.

Neni 6 Përcaktime

Në këtë rregullore, por edhe në çdo marrëveshje të blerjes së energjisë elektrike të lidhur mes palëve të identifikuar në nenin 2, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin:

ERE – Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.

Bord – Organi vendimarrës i ERE-s.

Ligj – Ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjet e tjera të aplikueshme.

Marrëveshje – kontratë e nënshkruar për shitblerjen e energjisë elektrike, e lidhur midis një të licencuari dhe një furnizuesi.

Objekti i marrëveshjes - do të thotë livrimi i mallit që shitësi do të ofrojë dhe blerësi do të pranojë.

Palë - shitësi dhe blerësi në një marrëveshje.

Energjia elektrike – nënkupton energjinë elektrike aktive dhe energjinë elektrike reaktive të transmetuar dhe të shpërndarë nga sistemi energjetik për të furnizuar përdoruesit në përputhje me sasinë e kërkuar.

Pikë livrimi – do të thotë pika e livrimit të shitblerjes së rënë dakord midis palëve.

Pikë matjeje - vendi fizik ku është realizuar pika e lidhjes dhe ku sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike.

Pikë lidhjeje - vendi fizik ku realizohet lidhja e përdoruesit me sistemin e shpërndarjes.

Çmimi – do të thotë çmimi i shitblerjes së energjisë, i vendosur sipas legjislacionit në fuqi.

Energji elektrike aktive: Energjia elektrike aktive është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe dhe përcaktohet nga integrali i caktuar i fuqisë aktive në kufijtë e kohës.

Njësia matëse e saj është Vat-Orë ose shumëfisha të saj:

1000 Wh = 1 kWh

1000 kWh = 1 MWh

1000 MWh = 1 GWh

1000 GWh = 1 TWh=1012Wh

Frekuenca – numri i cikleve alternative të rrymës për sekondë, në të cilin funksionon sistemi elektroenergjetik.

Furnizues - person i licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit në fuqi.

Matës - d.m.th. një pajisje për matjen dhe regjistrimin e vlerave të matura të energjisë elektrike.

Marrëveshje tregu - një marrëveshje, e cila përmban rregullat e tregtisë dhe përgjegjësitë e palëve në marrëveshje sipas legjislacionit në fuqi.

Prodhuar - një person i licencuar për të prodhuar energji elektrike.

Sistemi i matjes së energjisë elektrike - tërësia e pajisjeve të matjes: matësi, automati, transformatorët e matjes, mbrojtje e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave, pajisjet e transmetimit dhe të komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllore, të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike reaktive në objekt.

Periudhë marrëveshjeje - periudhë e aplikimit të marrëveshjes, e vendosur midis palëve.

KAPITULLI II

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR LIDHJEN E NJË MARRËVESHJEJE PËR BLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË LIDHUR NGA NJË I LICENCUAR ME NJË FURNIZUES

Neni 7

Shitja dhe blerja e energjisë elektrike

Shitësi do të pranojë të shtesë energjie elektrike dhe blerësi do të pranojë të blejë energji në sasinë, çmimin dhe termat e tjerë të përcaktuar në marrëveshjen e lidhur mes tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Livrimi dhe pranimi

1. Shitësi, në përputhje me sasinë e energjisë elektrike të përcaktuar në marrëveshje, duhet të programojë, të livrojë e të shesë dhe blerësi duhet të programojë, të blejë dhe të mundësojë pranimin e sasisë së kontraktuar në pikën e livrimit.

2. Blerësi do t'i paguajë shitësit sasinë e blerë të energjisë elektrike me çmimin e kontratës.

Neni 9

Tensioni /frekuenca/ ngarkesa

Energjia elektrike duhet të livrohet në tensionin, frekuencën dhe ngarkesën e aplikuar në pikën e livrimit dhe në përputhje me standardet e përcaktuara në kodet e miratuara nga ERE.

Neni 10

Programet e livrimit

Energjia elektrike duhet të livrohet sipas programeve të livrimit të specifikuar në marrëveshjen mes palëve. Me nënshkrimin e marrëveshjes, palët njoftojnë, sipas rastit, operatorin e sistemit të transmetimit ose kompaninë e shpërndarjes.

Neni 11

Transferimi i të drejtave

Livrimi do të kryhet duke i bërë të disponueshme sasinë e kontraktuar sipas marrëveshjes në pikën e livrimit.

Livrimi dhe marrja e sasisë së kontraktuar të energjisë elektrike dhe transferimi i gjithë të drejtave nga shitësi te blerësi kryhet në pikën e livrimit.

Neni 12

Matja e energjisë elektrike të livruar

1. Palët në një marrëveshje do të sigurojnë se livrimet dhe marrjet e energjisë elektrike do të maten ose verifikohen me sistem matjeje në përputhje me procedurat dhe standardet e përcaktuara në Kodin e Sistemit të Transmetimit, Kodin e Funkcionimit të Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike.

2. Matja e energjisë elektrike të livruar nga shitësi te blerësi do të kryhet në pikën e matjes, konform rregullave të përcaktuara në Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike. Për përcaktimin e

instalimit, mirëmbajtjes, kontrollit, testimit dhe vulosjes së sistemit të matjes të energjisë elektrike, palët i referohen Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike.

3. Matësi kontrollohet, kolaudohet dhe vuloset në prezencë të personave të autorizuar të shitësit dhe të blerësit.

4. Në ditën e caktuar nga palët në marrëveshje, përfaqësuesit e autorizuar prej tyre do të takohen për të lexuar aparatit matës të energjisë elektrike, që përcakton sasinë e energjisë së livruar nga shitësi te blerësi çdo muaj. Tregimi i numratorit të matësit do të lexohet dhe regjistrohet çdo muaj për të realizuar bërjen e bilancit të shitblerjes së energjisë elektrike.

5. Në çdo takim, sipas pikës 4, do të mbahet një procesverbal i leximit të aparatit matës, që do të firmoset nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve që kryejnë leximin, me përmbajtjen si më poshtë:

- Të dhënat e aparatit matës;
- Identitetin e personave që bëjnë leximin;
- Nënshkrimin e personave;
- Leximin e muajit paraardhës të matësit;
- Leximin aktual të matësit.

6. Në rastet kur përfaqësuesi i blerësit nuk paraqitet pa arsye në datën e caktuar, shitësi do të kryejë procesin e faturimit konform rregulloreve dhe do t'i dërgojë blerësit faturën. Blerësi është i detyruar të shlyejë vlerën e faturuar. Çdo paqartësi për saktësinë e faturës nga ana e Blerësit, do të jetë objekt rishikimi dhe rregullimi në muajt e ardhshëm.

Neni 13

Dokumentimi

1. Sipas një kërkesë të arsyeshme, palët:

a) do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë, i cili evidenton programet, sasitë, livrimet dhe marrjet e energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi nga termat e marrëveshjes dhe të livrimeve e marrjeve të energjisë elektrike;

b) do të bëjnë përpjekje për të kërkuar dhe blerë nga operatori i sistemit të transmetimit dhe kompania e shpërndarjes dhe do të ndajnë mes tyre çdo dokumentacion shtesë të nevojshëm për të verifikuar mospërputhjet mes flukseve të programuara dhe aktuale të energjisë elektrike.

2. Nëse njëra palë, me kërkesë të palës tjetër ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga pala tjetër, kryen shpenzime të arsyeshme të jashtme, për të verifikuar nëse pala tjetër ka dështuar të përmbushë siç duhet detyrimet e saj sipas termave të marrëveshjes për blerje energjie, këto shpenzime do të rimbursohen nga pala që nuk ka përmbushur detyrimet, nëse kjo kërkohet.

Neni 14

Faturimi dhe pagesa

1. Fatura. Shitësi do t'i dorëzojë blerësit për livrimin e energjisë elektrike një faturë sipas standardeve që kërkon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasitë totale të energjisë elektrike të shitur prej tij në muajin kalendarik paraardhës.

2. Pagesa. Blerësi do t'i kryejë pagesën shitësit kundrejt vlerës së faturës mujore. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga paraqitja e faturës mujore nga ana e shitësit. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e blerësit preken fondet monetare.

3. Vonesa në bërjen e pagesës. Nëse blerësi dështon në kryejnë e pagesës brenda afatit të përcaktuar në marrëveshjen midis palëve, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, konsiston në kamatën e llogaritur nga dita e fillimit të vonesës së debitorit (blerësit). Përqindja e kamatës bazohet në ligj dhe vendoset në kontratë. Kamata ligjore paguhet pa qenë i detyruar kreditori (shitësi) të provojë ndonjë dëm. Në llogaritjen e kamatvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa.

4. Shumat e diskutueshme. Për çdo reklamim që lidhet me saktësinë e faturës, do të jepet një shpjegim me shkrim nga shitësi dhe korrektimet në faturë do të bëhen vetëm brenda muajit të faturuar,

në të kundërt do të paguhet shuma e faturuar jo më vonë se data e afatit të pagesës dhe diferencat nga korrektimet do të reflektohen në muajt pasardhës.

Neni 15

Detyrimet mbi taksat dhe tatimet

1. Palët janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me të gjitha tarifatat, taksat, tatimet sipas legjislacionit në fuqi.

2. Shitësi do të paguajë të gjitha detyrimet lidhur me taksat, tatimet apo çdo detyrim tjetër sipas legjislacionit në fuqi në ose para pikës së livrimit dhe blerësi do të paguajë të gjitha detyrimet lidhur me taksat, tatimet apo çdo detyrim tjetër sipas legjislacionit në fuqi pas pikës së livrimit.

Neni 16

Risku dhe humbja

1. Shitësi do të përballojë të gjitha risqet shoqëruese dhe do të jetë përgjegjës për çdo kosto ose pagesë të imponuar që lidhet me programimin, transmetimin dhe livrimin e sasisë së energjisë elektrike të kontraktuar në pikën e livrimit.

2. Blerësi do të përballojë të gjitha risqet shoqëruese dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të imponuar që lidhet me pranimin dhe transmetimin e sasisë së kontraktuar pas pikës së livrimit.

Neni 17

Çmimi

1. Blerësi do të paguajë shitësin për energjinë e blerë me çmim të miratuar nga ERE sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Nëse në kohën e nënshkrimit të një marrëveshjeje nuk është miratuar çmimi për shitjen e energjisë elektrike, blerësi do ta paguajë shitësin mbi bazën e çmimit të fundit të miratuar nga ERE gjatë vitit që lidhet marrëveshja mes palëve.

3. Pas miratimit të një çmimi nga ERE, për periudhën e caktuar, palët do të bëjnë korrigjimet e nevojshme për sasi të faturuara dhe në vijim faturimi do të bëhet me çmimin e ri.

Neni 18

Forca madhore

1. Nëse ndodh një ngjarje e forcës madhore sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, secila palë, sapo të vihet në dijeni, do të njoftojë palën tjetër për fillimin e forcës madhore dhe do të bëjë një raport për ngjarjen dhe kohëzgjatjen e paafetësisë së saj për të vepruar si pasojë e forcës madhore.

2. Në atë rast, kur shitësi çlirohet nga detyrimi për të livruar energjinë për shkak të forcës madhore, edhe blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese për pranimin e mallit.

3. Asnjë palë nuk do të jetë përgjegjëse për kostot apo dëmet që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimeve, kur kjo mospërmbushje vjen si rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore.

Neni 19

Sanksionet për moslivrimin dhe pranimin e mallit

1. Kur pala blerëse detyrohet të blejë energjinë elektrike te një furnizues/prodhues tjetër, për shkak të një mospërmbushjeje të detyrimit për të livruar energji nga pala shitëse, sipas marrëveshjes së lidhur mes tyre dhe kur një mospërmbushje e tillë nuk justifikohet nga një rast i forcës madhore, atëherë pala shitëse duhet të kompensojë dëmin financiar të shkaktuar nga blerja e energjisë në shitës të tjerë të barabartë me produktin e diferencës së çmimit të përcaktuar në marrëveshje me atë të blerjes

së energjisë në treg me sasinë e energjisë elektrike të palivruar.

2. Kur pala shitëse detyrohet të shesë energji elektrike në blerës të tjerë, për shkak të një mospërmbushjeje të detyrimit për të pranuar energji nga pala blerëse sipas marrëveshjes së lidhur mes tyre dhe kur një mospërmbushje e tillë nuk justifikohet nga një rast i forcës madhore, atëherë blerësi duhet të kompensojë dëmin financiar të shkaktuar, të barabartë me produktin e diferencës së çmimit të përcaktuar në marrëveshje me atë të shitjes të energjisë në treg me sasinë e energjisë elektrike të papranuar.

3. Shumat e paguara në përputhje me këtë nen, do të faturohen dhe paguhen sipas nenit 14 (Faturimi dhe pagesa).

Neni 20

Pezullimi i zbatimit të kontratës

Nëse një palë (Pala që nuk ka përmbushur detyrimet) nuk do të shlyejë ndonjë pagesë sipas marrëveshjes, pala që i ka shlyer detyrimet, ka të drejtë, jo më shpejt se tri (3) ditë biznesi pasi i ka dërguar një njoftim me shkrim palës që nuk ka përmbushur detyrimet, të pushojë menjëherë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike dhe të çlirohet nga detyrimet e livrimit deri sa të marrë pagesën e garancisë ose pagesën e plotë, përfshirë të gjitha interesat dhe shpenzimet e aplikueshme për mospërmbushje të mospagesës së të gjitha shumave të prapambetura, që i detyrohet palës që i ka shlyer detyrimet.

Neni 21

Hyrja në fuqi e marrëveshjeve

Një marrëveshje e lidhur midis palëve që nuk kërkon miratimin e ERE-s, sipas nenit 10 germa “j” të Rregullave të tregut, hyn në fuqi në datën e caktuar nga palët.

Marrëveshjet e lidhura midis palëve, që kërkojnë miratimin e ERE-s, sipas nenit 10 germa “j” të Rregullave të tregut, hyjnë në fuqi me miratimin e saj nga ana e ERE-s.

Neni 22

Përfundimi i marrëveshjes

1. Një marrëveshje do të përfundojë sipas datës së përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar nga palët.

2. Marrëveshja mund të përfundohet në çdo kohë për një ose më tepër nga arsyet objektive të mëposhtme:

a) Kur njëra nga palët dështon në përmbushjen e bërjes së një pagese ose të ndonjë detyrimi material (përveçse kur ky detyrim është i çliruar sipas neni 18) sipas marrëveshjes, me kusht që në rast të një dështimi për të paguar, ky dështim nuk rregullohet brenda 2 ditëve biznesi nga kërkesa me shkrim, ose në rast të një dështimi tjetër të mospërmbushjes, ky dështim nuk është rregulluar brenda 10 ditëve biznesi nga marrja e kërkesës me shkrim.

b) Njëra nga palët falimenton ose nuk është në gjendje të paguajë borxhet ose dështon, ose pranon me shkrim paaftësinë e saj të përgjithshme për të paguar borxhet kur duhet.

c) Në rastet e një ngjarjeje të forcës madhore, kur zgjat më shumë se 30 ditë të njëpasnjëshme biznesi ose më shumë se 60 ditë në total gjatë një viti kalendarik.

d) Në rast se njëra nga palët ka dhënë garanci jokorrekte dhe të pavërteta.

e) Kur të dyja palët shfaqin interes për përfundimin e parakohshëm të marrëveshjes.

3. Në të gjitha rastet e përfundimit të një marrëveshjeje sipas këtij neni, palët do të përlllogarisin brenda 30 ditëve biznesi nga përfundimi i marrëveshjeve detyrimet financiare reciproke dhe afatin e shlyerjes së tyre.

Neni 23

Konformitetet dhe garancitë

1. Para nënshkrimit të një marrëveshjeje, palët do t'i kërkojnë njëra-tjetrës garanci dhe konformitete ligjore që ato i konsiderojnë të përshtatshme dhe të nevojshme në funksion të përmbushjes së qëllimit të marrëveshjes.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, palët në një marrëveshje me vullnet të lirë mund të kërkojnë garanci financiare për përmbushjen e kontratës jo më shumë se 10 % të shumës së vlerës së energjisë elektrike që do të livrohet. Kushti i garancisë do të çngurtësohet nga pala që ka kërkuar garancinë financiare, brenda 30 ditëve nga përfundimi i kontratës.

Neni 24

Legjislacioni

Një marrëveshje për shitblerjen e energjisë elektrike do të bazohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Neni 25

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të mosmarrëveshjeve, blerësi dhe shitësi do të bëjnë fillimisht përpjekje të zgjidhin konfliktin me mirëkuptim. Nëse palët nuk gjejnë mirëkuptim, ato mund të kërkojnë ndërhyrjen e ERE-s pa përjashtuar të drejtën për të zgjidhur konfliktin në rrugë gjyqësore ose sipas arbitrazhit të përcaktuar nga vetë ato.

KAPITULLI III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Amendamente të rregullores

Kjo rregullore amendohet me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.20, datë 28.3.2006

PËR VENDOSJEN E GJOBËS NDAJ KESH SHA

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 64 pika 1 germa “ç” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit nr.11, datë 23.2.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënien e licencave për aktivitetin e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, importit dhe eksportit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a., Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.3.2006, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe i Marrëdhënieve me Publikun, lidhur me mospërmbushjen nga

ana e të licencuarit KESH sh.a. të kushteve (përkatësisht pika 3.7 dhe pika 4.5) të vendosura në licencën e furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.56, datë 12.10.2005.

VENDOSI:

1. Të dënojë me gjobë të licencuarin KESH sh.a. në shumën prej 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për mospërbushjen e kushteve të përcaktuara në pikat 3.7 dhe 4.5 të licencës së furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.56, datë 12.10.2005.

2. Departamenti i Administrimit, Financës dhe Burimeve Njerëzore, si dhe Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit të marrë masa për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

Abonimet vjetore mund te bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendres së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel. 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

U dorëzua për shtyp më 6.4.2006
Doli nga shtypi më 12.4.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë